



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1684 Prot.
5

Tiranë, më 8/1/2014

Lënda: Urdhër për Kontrolluesin “Albarent Shpk”, Tiranë.

U R D H E R

Nr 01, datë 8/11/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit “Albarent Shpk”, Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrit nr. 239, datë 18.11.2013, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye inspektimi administrativ pranë kontrolluesit “Albarent Shpk” me adresë, Rr. Ismail Qemali, Pll. 34, Ap.1, Tiranë. Ky kontroll administrativ u fillua kryesisht nga Komisioneri.

Objekti i Kontrollit administrativ ishte:

- Informimi i subjekteve të të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale (neni 18 i ligjit);
- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale dhe ruajtja e konfidencialitetit (neni 27 dhe 28).

Nga kontrolli administrativ i zhvilluar, rezulton se kontrolluesi “Albarent Shpk” gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij privat në fushën e dhënies me qira të automjeteve dhe ofrimit të shërbimeve si agjenci turistike dhe transport ndërkombëtar, mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë “klientë”.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit, si dhe provat e administruara vëren se:

- Në rastin e ushtrimit të aktivitetit si agjenci turistike, kontrolluesi nuk e merr pëlqimin e klientit në formë shkresore (për përpunimin e të dhënave personale të tyre për të kryer prenotimin ose aplikimin për bileta udhëtimi me avion).

Komisioneri vlerëson se, në kuadër të zbatimit të nenit 6, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, është e nevojshme marrja e pëlqimit të klientit në formë shkresore pasi është shumë e rëndësishme që të provohet plotësimi i një prej kriterëve bazë të përpunimit të të dhënave personale, në mënyrë që përpunimi të konsiderohet i ligjshëm.

Sa i përket ushtrimit të aktivitetit në fushën e dhënies me qira të automjeteve, Komisionari vlerëson se meqenëse kemi të bëjmë me një marrëdhënie kontraktore, e cila arrihet me pëlqimin e të dyja palëve, atëherë kushti ligjor për përpunimin e të dhënave përmbushet.

- Të dhënat personale të klientëve, në kuadër të veprimtarisë si agjenci turistike, mbahen në kompjuter, në format excel, për një afat të pacaktuar.

Komisioneri vlerëson se mbajtja e të dhënave personale për një afat të pacaktuar bie në kundërshtim me shkronjën d) të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, në të cilin theksohet fakti se të dhënat personale nuk duhet të mbahen më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar (Parim i përgjithshëm i cili vlen në rastet kur nuk janë përcaktuar afate specifike nëpërmjet akteve nënligjore të miratuara nga Komisioneri). Në këtë kuadër Komisioneri vlerëson se, për klientët me të cilët ka përfunduar dhënia e shërbimit, të dhënat e tyre duhet të fshihen nga kompjuteri, ndërsa dokumentet shkresore duhet të shkatërrohen.

- Kontrolluesi nuk ka praktikë për të informuar klientët për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.
- Kontrolluesi në faqen zyrtare në internet nuk ka të publikuar “politikat e privatësisë”, që janë një paketë rregullash të cilat kanë si qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen (të cilët mund të jenë edhe klientë) mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave (klientë) dhe detyrimet e kontrolluesit (**Albarent Shpk**). Komisioneri vlerëson se politikat e privatësisë janë shumë të rëndësishme pasi ndikojnë në sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.
- Në kuadër të mbrojtjes së sigurisë së të dhënave personale të klientëve dhe ruajtjen e konfidencialitetit (neni 27, 28), Komisioneri konstaton se:

- 1) Kontrolluesi i ka marrë të gjitha masat për sigurinë fizike të ambienteve dhe për sigurinë e kontratave të klientëve duke i mbajtur në dollap me çelës. Kontratat në format elektronik janë të siguruara në kompjuterat e operatorëve,

të cilët janë të pajisur me “emër përdoruesi” dhe “fjalëkalimin” përkatës në mënyrë të personalizuar;

- 2) Kontrolluesi nuk disponon një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit, (detyrim i parashikuar në Udhëzimin nr. 22, datë 24.09.2012 për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë të të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël").
 - 3) Personat që kanë akses në të dhënat personale të klientëve dhe që aksesojnë të dhënat e siguruar nga sistemi CCTV, nuk kanë nënshkruar një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Në kuadër të përpunimit ligjor të të dhënave personale të mbledhura nëpërmjet sistemit të video-survejitimit (referuar Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video-survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar), Komisioneri konstaton se:
- 1) Kontrolluesi ka instaluar 8 kamera. Tre janë vendosur në ambientet e brendshme të zyrave të kontrolluesit, njëra ndodhet në hyrjen e pallatit (në ambientet e përbashkëta të pallatit, në korridor), dhe katër të tjera janë të pozicionuara jashtë ambienteve të kontrolluesit me pamje nga oborri i godinës dhe nga trotuari dhe rruga. Aksesit në të dhëna është i kufizuar vetëm për një person. Filmimet mbahen për një periudhë prej 10 ditësh dhe fshihen automatikisht.
 - 2) Sa i përket kamerës së vendosur në hyrjen e pallatit (në ambientet e përbashkëta të pallatit, në korridor), kontrolluesi nuk ka marrë në formë shkresore pëlqimin e 75 % të banorëve të godinës, në zbatim të shkronjës b), të pikës 5, të Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar.
 - 3) Sa i përket pozicionit të kamerave të jashtme (përkatësisht kamerës numër 03, 04 dhe 05 konstatohet se kanë një kënd të gabuar shikimi pasi janë të drejtuara nga trotuari dhe nga rruga (duke mos fokusuar vetëm godinën e Albarent Shpk) dhe regjistrojnë edhe kalimtarët.
 - 4) Kontrolluesi nuk ka një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara nëpërmjet sistemit të video survejitimit.
 - 5) Në ambientet e brendshme të survejuara me kamera ka tabela informuese lidhur me veprimin e sistemit të video survejitimit, por nuk ka tabela për kamerat jashtë.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

U R D H E R O J

1. Në zbatim të shkronjës d) të nenit 5 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të dhënat personale të klientëve të përpunuara në kuadër të veprimtarisë si agjenci turistike (që mbahen në kompjuter në format excel), me të cilët ka përfunduar dhënia e shërbimit për prenotimin e biletës së avionit, të fshihen nga kompjuteri, pasi mbahen për një afat që e tejkalon qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar. Ato mund të përpunohen vetëm nëse klienti ka dhënë pëlqimin paraprak në formë shkresore.
2. Në zbatim të shkronjës a), të pikës 1, të nenit 6 të ligjit, për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale të klientëve, në kuadër të veprimtarisë si agjenci turistike, të merret në formë shkresore pëlqimi i informuar i klientëve.
3. Në zbatim të nenit 18 të ligjit, kontrolluesi duhet të hartojë një praktikë për të informuar klientët për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për mënyrën e përpunimit, për të drejtën për akses si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tyre.
4. Në ambientet e survejuara me kamera (jashtë godinës) të vendosen tabela informuese në pozicione lehtësisht të dukshme (sipas modelit të parashikuar në Udhëzimin nr. 3 të cituar më sipër) lidhur me veprimin e sistemit të video survejimit (bazuar edhe në nenin 18 të ligjit).
5. Të rregullohet këndi i kamerave të jashtme (përkatësisht kamerës numër 03, 04 dhe 05), të drejtuara nga trotuari dhe nga rruga, duke shmangur regjistrimin e kalimtarëve. Kamerate duhet të fokusohen vetëm nga fasada e godinës dhe hyrja e kompanisë Albarent (në kuadër të zbatimit të nenit 5/1/c të ligjit).
6. Për kamerën e vendosur në hyrjen e pallatit (në ambientet e përbashkëta të pallatit, në korridor), kontrolluesi duhet të marrë në formë shkresore pëlqimin e 75 % të banorëve të godinës, në zbatim të shkronjës b), të pikës 5, të Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar dhe neneve 5/1/b dhe 6/1/a të ligjit.
7. Në zbatim të nenit 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 “Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar:

- Personat që kanë akses në të dhënat personale të klientëve, dhe regjistrimet e kamerave, duhet të nënshkruajnë një deklaratë konfidencialiteti për mbrojtjen e të dhënave personale.
 - Të hartohet një rregullore të brendshme lidhur me sigurinë e të dhënave personale të përpunuara për qëllime të ushtrimit të aktivitetit dhe të dhënat e mbledhura nga sistemi i video survejimit. Në të duhet të parashikohen masa konkrete sigurie, detyrimet e kontrolluesit dhe të drejtat e subjekteve të të dhënave. (Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë).
8. Në faqen zyrtare në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave (klientë) dhe detyrimet e kontrolluesit (**Albarent Shpk**). Politikat e privatësisë synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.
9. Këto detyrimeve të rëndësishme që ju ngarkon ligji, të kryhen brenda një afati kohor prej 40 (dyzetë) ditësh, nga dita e marrjes dijeni për këtë urdhër;
10. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
11. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas të cilit: “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI
FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

